



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 14

Datë: 05. 02. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
2. Aktivitetet e ZRPPC-së

-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve

3. Raport i Këshillave të KQZ-së;

Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Rishqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së nominimeve për anëtar të KVV-ve për Komunën e Prizrenit dhe Mitrovicës së Veriut, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021,

-Pranimi i pakove të fletëvotimeve përmes postës

4. Të ndryshme.
-

1. **Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

Valdete Daka: E hapi mbledhjen e 14-të të KQZ-ës. Më pikat siç janë propozuar. A ka dikush vërejtje?

Čemailj Kurtiši: Ju kërkoj falje, por unë vetëm deshta që ta përcjellë një shqetësim të bashkqytetarëve tanë nga Franca. Edhe unë jam çuditur, por po ua lexoj edhe një porosi. Një bashkëqytetare ka shkuar në postë për ta përcjellë letrën për votim, por në postë i kanë thënë se për Kosovë nuk ka shërbime postare për momentin. Ajo, jeton rreth 40 kilometra larg qytetit Sentetien ! Ka raste të njëjta edhe në qytetet tjera, dhe a mund të shohim se c'mund të bëjmë...!

Valdete Daka: Jo, nuk kam asnjë ide, as nuk kam dijeni sepse nuk kam qysh me ditë se çfarë bënë posta e Francës po ashtu nuk e di as çfarë bënë posta e Kosovës por gjithsesi ndoshta mundet sekretariati më komunikuar me posten dhe ata me ju dhen ndonjë sqarim më të hollësishëm.

Sami Kurteshi: Faleminderit Kryesuese, lidhur më çështjen që e ngriti z. Kurtisi, kjo është e vërtet kemi marur shumë informata dhe nga qytetaret e tjerë, një mundësi është që normal që mos me humb votën ata, të gjithë ata që jetojnë afër kufijve më Belgjikën, Luksemburgun, Gjermanin, Zvicrën, Italinë të gjithë munden me dal në simuluesin munden me dal në ato shtet që me dërguar dhe nga atje vjen sa për ndihmë.

Arianit Elshani: Gjatë ditës së djeshme në rrjetet sociale kam pa edhe postimi të cila janë bërë, duhet që të ndiqen këto dhe të hetohen edhe nga policia se kush qëndron brenda atyre sondazheve që po krijohen në emër të KQZ-ës. Po e potenconi një fakt është lajmeonline, votoni online nga KQZ d.m.th po thirren në emër të KQZ-ës, andaj kërkoj dhe nga KQZ-ja që të demantohen këto kërkesa për përfshirje ku ndoshta dhe ju merren të dhënat personale, meqenëse është një link aty, ku dhe ridrejtohen njerëzit, kërkojë që të ndiqen të gjitha këto dhe demantohen publikisht, dhe tjetra që të ndiqen edhe përmes policës dhe prokurorisë këto raste ku persona të pa autorizuar bëjnë thirrje në emër të KQZ-ës.

Valdete Daka: Më siguri që zëdhënësi le ta përgatit një komunikatë për shtyp, meqenëse unë nuk kam facebook nuk e di çfarë po ndodh neper këto rrjete, por gjithsesi zëdhënësi mundet me lëshuar një komunikatë në emër të KQZ-ës, me demantua dhe me deklarua që ne nuk bëjmë sondazhe e as nuk i kemi dhen askujt të drejtë që të bej sondazhe ne emër të KQZ-ës, ashtu qysh nuk i kemi dhen kurrë. Gjithsesi ne do të dalim zyrtarisht dhe do ta demantojmë dhe do ti ftojme edhe qytetaret që të mos ju besojnë dhe as mos të dhanë shënime personale sepse mund të keqpërdoren, nëse nuk kemi çështje të tjera. Kush është për këtë rend dite? Vazhdojmë me rekomandimet e ZRPP-ës për akreditimi.

2. Aktivitetet e ZRPPC-së

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve

Yll Buleshkaj: Jemi në shqyrtim të mbi 17.944 aplikacioneve që kanë ardhur nga partitë dhe entitetet tjera, të entiteteve të mëdha jemi duke shkuar më kujdes dhe një nga një, për këtë dhe me ngadalë po shkon procesi, ndërsa te entiteteve më të vogla po i kryem të gjitha verifikimet me shpejt dhe rekomandojmë të ju me shpejt që të akreditohen, jemi munduar që rekomandimit njërit nga anëtarët, rekomandimi jonë të vijë pak më herët të ju, e kemi dërguar me herët më email por nuk e di a e keni pasur rastin që të shihni në email dhe para jush kemi paraqitur rekomandimin për akreditim të vëzhguesve si në vijim..

Valdete Daka: Për RTVpuls-Do kemi 7 vëzhgues. Kush është për? Faleminderit. Nga OJQ vendore QPA 5 vëzhgues. Kush është për? 4 vëzhgues të PREBK-ës. Kush është për? 18 vëzhgues nga media vendore publike RTK2. Kush është për? 3 vëzhgues të OJQ vendore CZRZ. Kush është për? Është media vendore ZËRI më 6 vëzhgues. Kush është për? Është media vendore ARBRESHinfo më 6 vëzhgues. Kush është për? Edhe me këtë ka përfunduar akreditimi a po kemi ende.

Yll Buleshkaj: Sot përfundon afati për aplikim për akreditim për vëzhgues të subjekteve politike dhe OJQ-ve vendore, ndërsa të martën është afati i fundit për aplikim për media dhe organizatave ndërkombëtare.

Valdete Daka: është mirë të i njoftojmë të gjithë që sot në orën 18:00 përfundon afati për aplikim për akreditim.

Yll Buleshkaj: I kemi njoftuar të gjitha entitetet të cilat janë certifikuar si subjekte politike dhe beojmë që nuk do të kemi probleme.

Valdete Daka: Vazhdojmë më KOZ-in.

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Rishqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së nominimeve për anëtar të KVV-ve për Komunën e Prizrenit dhe Mitrovicës së Veriut, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021:

Alim Rama: Sot në KOZ kemi bërë rishqyrtimin dhe miratimin e përbërjes e nominimeve për anëtarët e KVV-ve, me rekomandim të disa subjekteve politike dhe në disa komuna të cilat i kanë bërë këto

rekomandime janë në bazë të vendimit që kemi marrë pardje dhe me sugjerime lidhur me listat që i keni para jush, këshilli rekomandon për aprovim.

Valdete Daka: Të gjithë janë dakord, nuk kemi më vërejtje nga asnjë subjekt apo komunitet. Kush është për zëvendësimin edhe plotësimin e përbërjeve? Vazhdojmë me piken tjetër pranimit të pakove të fletëvotimeve përmes postës.

2. Pranimit të pakove të fletëvotimeve përmes postës

Alim Rama: Po ashtu, Sekretariati rekomandon që të ju dërgohet një letër postes së Kosovës që të i pranoni sipas praktikave të deri tashme të gjitha fletëvotimet që kanë ardhur në qendrën tranzitore postare, të caktohet një kohë në koordinim e cila kjo kohë që është këtu mundet që të ndërrohet por një kohë ka me qenë e përshtatme në koordinim mes sekretariatit dhe postës. Po ashtu kjo kohë i njoftohet të gjithë vëzhguesve të interesuar, më i përcjell këto pako. Letra do i dërgohet postave të Kosovës për QTP, këto dy letra të postes ka rekomandim unanimit, ndërsa ka qenë një pjesë e diskutueshme të kalendari, sikur edhe mënyra... Këto dy letra kanë marrë kërkesën unanime.

Valdete Daka: Kush është për?

Eshref Vishi: Kam pyetje për z. Rama. I kemi 2 shkresa këtu cila është e administratës dhe, cila ka dalë nga KOZ-i.

Valdete Daka: Të dyja janë, dhe nuk kanë përmbajtje të njëjtë, lart është titulli, rasti kur të gjitha paketat do të merren në Fushë Kosovë dhe kjo tjetra kur do të merren në postën numër 6.

Eshref Vishi: Unë e kam një çështje të cilën dua ta ngriti këtu tek pasuesi i 3-të i kësaj letrës për Prishtinën e cila thotë kështu: paketat e transportuar nga QTP-ja në postën numër 6, nga posta numër 6 do të i tërhiqmi me mbikëqyrje të Policisë së Kosovës dhe vëzhguesve të akredituar ku mendojmë që prezenca jonë më qëllim të tërheqjes të bëhet çdo ditë nga ora 14:00 deri në ora 15:00. Pse çdo ditë dhe cilat janë mundësit e fahut postar që mos me u tërhiqen çdo ditë? Sepse, po më duket ngarkesë që çdo ditë të bëhet tërheqja e tyre.

Alim Rama: Sepse, kjo është praktik dhe sekretariati mundet me shkua në detaje, mundemi më ta përshkruar bisedën, është praktik që këto paketat që të merren menjëherë, çdo ditë që të mos mbesin aty, njëherë ruhen në qendrën tranzitore, nxirren nga aty për shkak të kohës dhe hapësirës.

Eshref Vishi: Cilat janë praktikat e administratës?

Burim Ahmetaj: Sekretariati çdo ditë do të i marr nga posta, nga fahu postar dërgesat të cilat dërgohen në fahun postar. Pa marr parasysh a janë nga posta e Kosovës apo posta të tjera të shpejta sepse kemi një numër të madh të postave të shpejta që janë 4sosh dhe do ta kemi një zyrtar tonin i cili do të bëjë pranimin e dërgesave nga postat e shpejta dhe do të vendosen në fahun postar, pas kësaj çdo ditë do të marrim dhe do të dërgojmë në vendin e pritjes që edhe në objektin e ministrisë së infrastrukturës aty do të presin deri në ditën e shtunë një ditë para ditës së zgjedhjeve, pas kësaj periudhe pastaj do të dërgohen në QNR ku do të procesohen, në Ministrinë e Infrastrukturës do të jetë qendra e pritjes dhe për shkak të numrit të madh dhe nga praktikat që kemi pasur edhe nga vitet e mëhershme, çdo ditë në bazat ditore është dashur të shkojnë më komision, praktikash me polici dhe me vëzhgues të merren dërgesat dhe tani kur e dimë që është numri i madh nuk ka kapacitete as postat me i mbajt, kështu që e kemi vendin e pritjes që është në objektin e Ministrisë së Infrastrukturës janë policia që e sigurojnë objektin, janë edhe dyert e siguruara, po ashtu do të instalojmë edhe kamera brenda, kamerat jashtë janë kështu që këto janë masat të cilat i kemi marrur për vendin e pritjes që është deri një ditë para ditës së zgjedhjeve dhe në baza ditore do të marrim.

Tani, dinamikën e marrjes, e kemi përcaktuar në një dinamikë mirëpo kjo dinamikë mund të na ndryshojë varësisht nga dërgesat, dhe varësisht se sa tregon edhe postat kur është e gatshme me i procesuar të gjitha ato dërgesa. Ne e kemi parapa një periudhë mirëpo a kanë kapacitet postat me i procesuar deri në ora 16:00 ose deri në 17:00, ndoshta ky orar do të zgjatet, mirëpo do të i njoftojmë edhe vëzhguesit dhe të gjitha palët po ashtu edhe policinë e Kosovës në kohën kur do të shtojmë saktë, kështu do ta keni edhe ju njoftimin si anëtar të KQZ-ës, kohën kur do të bëhet tërhiqja për çdo në baza ditore.

Arianit Elshani: Në lidhje me këtë që e ngriti z. Vishi, në fakt edhe unë po i shoh të dy shkresat, një shkresë ku thotë për posten tranzitore që do të shkojmë çdo ditë me i marr si KQZ dhe kjo tjetra për fahun postar që po ashtu shkojmë çdo ditë, mirëpo të kjo e fahut postar nënkuptojmë që fahu postar i merr nga qendra tranzitore, në Fushë Kosovë i merr çdo ditë, po mendojmë që ndoshta me shkua çdo dy ditë në qendrën tranzitore dhe çdo ditë në posten.

Valdete Daka: Vetëm një pyetje e kam. Pse shkojmë në qendrën tranzitore, në qoftë që qendra tranzitore i qonë në postë ?

Burim Ahmetaj: Qëllimi është që mos me mbet aty pafundësisht pakot që vinë, sepse na shkaktojnë vonesa në vend çfarë vjen dërgohet automatikisht prej aty që mos më mbet në mënyrë që të procesohen sa më shpejt sepse dinamika jonë nuk korrespondon me dinamikën e postës, ne kemi gjithçka emergjente dhe pakot që vinë, në momentin që vinë duhet me u transferua. Hapësirën në Ministrinë e Infrastrukturës vendin e mbajtjes kemi hapësirë të mjaftueshme, i kemi marr masat që i ceka edhe me herët. Mirëpo na duhet patjetër në baza ditore ose ndoshta na duhet të shkojmë edhe

dy herë në ditë më shkuar me i marr për shkak së do të ketë numër të madh të dërgesave dhe nuk kanë kapacitete më i mbajt, ndoshta do të na duhet edhe deri në 6,7 apo 8 në mbrëmje sepse ato duhet që të regjistrohen. Duhet të procesohen, janë procedura janë protokolle kështu që neve na duhet me i respektuar të gjitha këto.

Ibrahim Selmanaj: Bere mirë Kryeshef që e sqarove dhe unë po mendojë që duhet të jemi shumë efikas në këtë drejtim po pajtohem me faktin që nëse është e nevojshme 2 herë apo 3 herë në ditë më shkuar të i tërheqim fletëvotimet, ditët janë në kalim e sipër dhe mendojë se duhet të jemi shumë azhur dhe efikas në këtë drejtim sigurisht së duhet të jemi të kujdesshëm sepse është proces i ndjeshëm të i ruajmë votat, ta kemi parasysh edhe nga momenti i marrjes e deri të dorëzimi dhe numërimi, duhet të jenë vëzhguesit, duhet të jenë ekipet përcjellës dhe unë besojë që do jemi edhe ne vigjilent në këtë drejtim.

Sami Kurteshi: Tani një pyetje e imja teknike. A po i miratojmë njëherë këto dy letra pastaj po bisedojmë për çështje tjera apo po e përfundojmë këtë temë?

Alim Rama: Kemi edhe një sugjerim tjetër që ka ardhur, për shkak që është diskutuar në KOZ, për shkaqe të natyrës së si operon posta e shpejt ata në bazë të praktikave të tyre, ata nuk i dorëzojnë në kuti postare. Një rekomandim ka qenë që të qëndron aty zyrtari jonë që të i pranon në posten numër 6, por unë mënojë që ky ekip i autorizuar po ashtu të i dërgohet... 90% bartës siç ka qenë edhe praktika nga 2009 deri në 2019, që të vazhdon praktika që postat e... të pranohen drejtpërdrejt nga ajo, duke marr parasysh që janë operatori me i madh në treg.

Sami Hamiti: Ne, e diskutuam në KOZ dhe nuk është e vërtet që kishim mendime përafërsisht të njëjta për atë se si të vinë, këtu janë 4 posta të shpejta, 3 nga to kanë marrëveshje me posten për dorëzim, kurse KQZ-ja ka marrëveshje me posten sepse është postë shtetërorë nuk ka marrëveshje me asnjë postë të shpejtë tani jemi në një situata që DEHAELL, nuk paska marrëveshje posten dhe kërkon që të i dorëzohet, propozimi ishte i mirë, e pash edhe Besniku dhe Kryeshefi që në fahun postar mund të shkojnë zyrtari i jonë i listës votuese të i pranon dhe i fut në sistem, i autorizuar si është me rregull, kërkesat e tjera që shkohet neper institucione, i dorëzoi drejtpërdrejt. Posta e shpejt e dorëzon të zyrtari i cili është i autorizuar nënshkruhet në fahun postar edhe me ruten që e kanë institucionet, shkojnë në institucione me të cilët kemi marrëveshje dhe konsideroj që është rruga më e mirë në kuptimin ligjor dhe të institucioneve. Ku të shkojnë ato vota në të gjithë kohën po themi që grumbullohen në një vend, ai zyrtar është zyrtar i joni, zyrtari i DEHAELL-it shkon aty edhe prezantohet kush është sepse futet në një institucion ku i dorëzon dhe siguria është e plot. Asnjë problem tjetër nuk ka që me u be dilema tjera këtu. Thjesht kjo ishte që propozimi i cili erdhi dhe e ishte shumicën në KOZ.

Alim Rama: Arsya pse ajo nuk i dorëzon në postë është shumë ditur, sepse ajo nuk i dorëzon postat në kuti por të përsone i autorizuar ose tek institucioni i autorizuar në këtë rast institucioni i autorizuar është KQZ-ja dhe duhet dikush që të i pranojë në emër të KQZ-ës, sepse ajo është çështja kryesore, unë nuk po kuptojë logjikën në qoftë që ne kemi hapësirën dhe personi qëndron tek ajo hapësirë, zyra që e ka rekomanduar sekretariati këtu në ministrin, pse aty nuk të vjen drejtpërdrejt posta, pse ka nevojë DEHAELL më dërguar deri ne postë e nga posta të vije këtu, duke marr parasysh sipas lajmeve që kanë dalë diku 7 deri 8 kuti më postë kanë ardhur. Pse duhet me qëndrojnë në postë duke marr parasysh që kemi hapësirë të siguruar, të evidentohet në prani të vëzhguesve, në prani të personit të autorizuar të KQZ-ës, ta thjeshtojmë procesin nuk kemi nevojë që të i sjellim kështu rreth e rreth.

Sami Hamiti: Pikërisht për mos më komplikua procesin, sepse mërgata votat i ka dërguar në fahun postar numër 6, dhe adresa është ajo. KQZ-ja për atë adresë është pikërisht atje prandaj absolutisht gjithqka është në rregull që të dorëzohet në vendin ku e ka adresën, KQZ kemi këtu, KQZ kemi në ministri, kemi në QNR, ai e ka shumë saktë adresën zyrtari është aty, i pret i fut në sistem dhe jo që komplikohet por thjeshtohet sistemi.

Arianit Elshani: E kam një hall shumë më të madh e kam një listë këtu me shumë se 250 personave që ma dërguan tani të diasporës, që nuk ju ka figuruar emrin në listën votuese, halli më i madh qysh me ju arrit vota këtyre që janë me vonës edhe që do kohë edhe të verifikohet prej KQZ-ës, meqenëse i kanë dërguar aplikacionet më kohë, sa i përket këtyre që janë në Kosovë votat që mbërrin këtu, problemi dhe sfida me e madhe është me mbërrit këtu në këtë kohë të pandemisë, kështu që sa do që mbërrin, ku do që mbërrin ato le të dorëzohen në fahun postar, kur të është në Kosovë nuk mundet me hup ndokund.

Sami Kurteshi: Tani nga përvoja shumë vjeçare me sa di unë nuk pranon postë për fahun postar, sepse ajo e ka parimin prej dorës ne dorë tek personi edhe duhet që të nënshkruaj ky është parimi i tij me sa unë e njohë, tani nuk e di se kur i kanë dorëzuar ata por unë jam i bindur që kur e sheh ... fah postar, është një kuti ku vetëm futet posta pa nënshkrim nuk e pranon këtë duhet që ta dini, d.m.th ajo nuk dërgon postë në fahun postar. Çështja ime kryesore është që këtu po a shkruan: pranimi e premtë 12.02.2021, tani unë po dua më e sfiduar këtë datë në mënyrë ligjore unë kam kërkuar që të jetë i 13 shkurt, po e shoh se dikush ka ngulur këmbë, e pra unë po them që kjo është e kundërligjshme. Deri në orën 24:00 të premtën më 12 shkurt nuk përmbushet afati sipas aktgjykimit sipas GJK, 24 orë po mbesin 36 orë minimum në ora 12:00, pra ne ja shkurtojmë prej 7-8 orëve njerëzve kohën. Këtë të drejtë nuk kemi ne më vendim apo administrativ me e be, thjesht i 12 është gabim, harroheni këtë punë ne ja vjedhim disa orë.

Çështja tjetër është, e unë ju kam thënë që ligji për procedurën e përgjithshme administrative i cakton këto gjera nuk është marr parasysh, pra unë po dua me jua lexuar ato pjesë të cilat janë me interes për çështjen tonë, ligji thotë një veprim administrativ për arsyeje të mbrojtjes të interesit publikë kufizon apo cenon të drejtat dhe interesat juridike të një personit duhet të jetë në pajtim me parimin e proporcionalitetit në po e kufizojmë një drejt të njerëzve për disa orë, njëherë ja kemi shtyrë për 20 orë tani po ja kufizojmë për disa orë, paragrafi i 2 një veprim administrativ është në pajtim vetëm nëse i plotëson këto kushte është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar më ligj, është i përshtatshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj dhe pjesa e 3-të është qëllimi si duhet. Tani ky ligj përcakton edhe afatet për kryerjen e një veprimit procedural që përcaktohen nga ligji apo akti nënligjor, është ligji, është rregullorja, është aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese që thotë 24 orë. Nëse ligji apo akti nënligjor nuk e precizon një afat të përcaktuar, afati përcaktohet nga vetë organi që jemi ne publik që kryem procedurën në përputhje me nenin 10 të këtij ligji.

Neni 10 i këtij ligji, thotë procedurat administrative nuk ju nënshtrohet një forme të caktuar më përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe më ligj, organi publik zhvillon procedurat administrative sa më të shpejtë dhe sa me pak shpenzime për të dhe për palën duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm edhe të përshtatshëm të procedurës administrative kjo është çështja. Një afat procedural i paraparë më ligj dhe akt nënligjor mund të shtyhet vetëm nëse dispozitat përkatës shprehimisht lejon një shtyrje të tillë apo një pajtim më nenin 79 të këtij ligjit, neni 79 i këtij ligji thotë përpos kur ndalohet shprehimisht nga ligji në rastet për arsyeje të justifikuar e jo për fajin e vetë, një palë që është e penguar për respektimin e një afati procedural mund të kërkojë rivendosjen e afatit të humbur. Ne ja kemi shkelur afatin mërgimtareve për 20 orë kurse kemi publikuar fletëvotimin, ata kanë kërkuar shtyrje, ne kemi kërkuar shtyrje për 10 ditë ose për aq ditë sa nuk i kemi lejuar më shfrytëzua mjetin juridik kjo nuk është bërë, rivendosja në afat mund të kërkojë për humbjen e afatit për parashtrimin e kërkesës fillestare, mjetit juridik administrativ që nuk ja kemi respektuar, për kryerjen e një veprimi tjetër procedural gjatë procedurës administrative si dhe për çdo afat tjetër që ecën kundrejt palës. Afati i përcaktuar nga organi publik mund të shtyhet më kërkesë të palës më kusht që të ketë arsyeje për një shtyrje të tillë ata kanë arsyeje të plotë ne ja kemi shkelur afatin. Kërkesa e palës duhet të parashtrohet pra skadimit të afatit që kërkojë të shtyhet, ata e kanë parashtruar këtë ne duhet që ti marrim parasysh, data 12 shkurt e premte është e kundër ligjshme përveq që është e kundër ligjshme unë po kërkoj është njëherë, meqenëse këtu po e thotë që nuk është përcaktuar afati po kërkoj që data 13 shkurt ora 19:00 të caktohet si momenti i fundit kur pranohet posta nga mërgata.

Valdete Daka: Ne, e kemi aprovuar një plan operacional dhe dje e kam marr dhe e kam lexuar procesverbalin të gjithë e kemi votuar, është aprovuar një plan operacional si i tillë më atë plan

operacional është paraparë që data e fundit kur mund të pranohen pakot më fletëvotime nga mërgata është 12 shkurti pra 24 ore para ditës së zgjedhjeve, të gjithë ata që konsiderojnë që ne ja kemi shkelur të drejtën le të urdhërojnë le të ankohen në PZAP, duke përfshirë dhe subjektet të cilat konsiderojnë që ju është shkelur ndonjë e drejt votuesve le të ankohen në PZAP, ta sqarojmë edhe njëherë këtë çështjen e datës edhe pse e kemi aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese por megjithatë kush do që konsideron që ja kemi shkelur një të drejtë le të ankohen në PZAP deri sa ka kohë dhe PZAP-ja besojë që për një ditë do të na jep përgjigjen dhe e dimë edhe ne edhe ju se a kemi të drejtë apo jo, kështu që kotë e diskutojmë ne e kemi aprovuar një plan operacional.

Nuk është një ramje nën brez sepse, unë jam duke marr ramje nën brez që 3 javë, që 3 javë emri im nuk zbret nga faqet e mediave, që 3 javë personaliteti jem është bërë personaliteti ma i urryer i këtij shteti, duke falënderuar disa personalitet të caktuar. Ligji për zgjedhjet e përgjithshme votimi jashtë Kosovës neni 96, paragrafi 2 thotë : vota përmes votimit jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve sikurse përcaktohet më anë të rregullave të KQZ-ës, rregulla numër 2 e cila rregullon çështjen e votimit jashtë Kosovës ku thotë: neni 4, paragrafi 4 i kësaj rregulle thotë votat jashtë Kosovës duhet të pranohen nga KQZ-ja 24 orë para ditës së zgjedhjeve, tani vetëm po ju pyes unë kur fillon 14 shkurti në ora sa fillon?

Sami Hamiti: Është e vërtet po sillemi rreth asaj datës dhe mbledhjen e kaluar dhe tani thash që të kërkohet një interpretim sepse tani po e bëjmë dilemën na kur fillon dita e në sa ora. 24 orët që e ka përcaktuar Gjykata Kushtetuese në rastin e viti 2019, thotë që dita fillon në orën 24:00, cilën datë llogaritet 24 orë përpara heshtja zgjedhore, kur fillojnë dënimet prej PZAP-ës , të gjithëve po ju themi me datën 12 shkurt në orën 24:00 mos sponsoren neper facebook sepse fillon heshtja zgjedhore sepse është një ditë para zgjedhjeve. A e ke të sanksionuar nga PZAP-ja dhe është një vendim i kushtetueses nuk jemi duke shkelur na asgjë, edhe nëse dikush e konsideron që po shkelim tash e kemi dilemën, unë nuk e di z. Kurteshi si e pretendon ti 24 orë para zgjedhjeve deri në ora 19:00 pse deri atëherë sepse dita e votimit fillon në ora 07:00, nëse e ke pretendimin që dita e zgjedhjeve fillon në ora 07:00 edhe 24 orët përpara i bije më 13 shkurt në ora 07:00 por ndryshe e ka konsideruar një organ, një gjykatë. Të gjitha aktgjykimet të cilat kanë ardhur janë thirrur në ligj special që e quan këtë ligjin e zgjedhjeve.

Arianit Elshani: KQZ-ja kur ka pasur vullnet politik këtu i ka mbledhur dhe i ka numëruar 7-8000 vota herën e kaluar, i ka marr 7-8000 vota i ka pranuar në zgjedhjet e 6 tetorit që kanë qenë pas afatit, ka pasur vullnet politik por pastaj pa pasur aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, sot në dhjetor d.m.th e kemi atë aktgjykim si bazë, kështu që vullneti KQZ-ës realisht që me pas edhe shumë me shumë afate...